



**DORACAK PËR
MËSIMDHËNËSIT PËR
PUNË ME NXËNËSIT
QË JANË NË TRAJTIM
NË INSTITUCIONE
SHËNDETËSORE DHE
NË KUSHTE SHTËPIE**



Parathënie

Të nderuar mësimdhënës,

Ju jeni ata që mbartni dritën e arsimit në vendet ku përditshmëria është më e vështirë – në dhomat spitalore dhe në shtëpitë e fëmijëve që përballen me sfida afatgjate shëndetësore, duke u shndërruar kështu në burim shprese, mbështetjeje dhe frymëzimi..

Misioni juaj tejkalon kufijtë e transmetimit të dijes; ai përfaqëson një akt shprese, mbështetjeje dhe motivimi.

Në punën tuaj përfshihen me nxënës që janë duke u trajtuar me sëmundje të ndryshme mjekësore, përfshirë sëmundje malinje, sëmundje kronike, probleme kardiologjike dhe neurologjike, çrregullime autoimune dhe të tjera. Fëmijët që përballen me sëmundje të caktuara, si leukemia, limfoma ose sëmundje të tjera malinje, shpesh kalojnë muaj të tërë në ambiente spitalore ose në mjedis të kontrolluar shtëpiak. Në ato momente, ju nuk jeni vetëm mësimdhënësit e tyre; ju jeni ura që i lidh ata me fëmijërinë normale, me bashkëmoshatarët e tyre dhe me ëndrrat që sëmundja nuk duhet t'i ndërpresë.

Puna juaj kërkon durim, empati dhe kreativitet. Çdo orë që zhvillonit është më shumë se një mësim; ajo është një mesazh se këta fëmijë nuk janë të harruar, se ata kanë një të ardhme, dhe se jeta e tyre nuk kufizohet vetëm në terma mjekësorë dhe protokolle terapeutike. Me çdo shpjegim, me çdo buzëqeshje dhe me çdo fjalë inkurajuese, ju sillni forcë atje ku shpesh mbizotëron frika.

Të jemi të singertë, kjo punë është e vështirë. Por, pikërisht ju e bëni atë fisnike, duke e shndërruar në një shembull të asaj se çfarë nënkupton edukimi dhe kujdesi i vërtetë.

Ju falënderojmë për përkushtimin tuaj, për humanizmin tuaj dhe për faktin që çdo ditë dëshmoni se arsimi është një të drejtë që duhet të jetë i aksesueshëm për të gjitha fëmijët, pa marrë parasysh gjendjen e tyre shëndetësore..

Me respekt dhe falënderim,
Ministrja, prof. dr. Vesna Janevska



Hyrje

Kur një nxënës përballet me një sëmundje serioze, arsimi i tij/ përpjekja e tij mësimore patjetër pëson ndryshime. Varësisht nga lloji i sëmundjes dhe terapive, nxënësi mund të mungojë për një periudhë të gjatë (javë ose muaj) nga mësimi i rregullt, për shkak të trajtimit në institucione shëndetësore, spitale ditore dhe/ose në kushte shtëpie. Mungesa e zgjatur nga shkolla për shkak të trajtimit mjekësor, marrjes së terapive dhe monitorimit të gjendjes shëndetësore ka patjetër një ndikim për suksesin dhe përparimin e nxënësit gjatë procesit arsimor.

Prandaj, vazhdimi i arsimit për nxënësit që janë në trajtim për më shumë se tri javë, qoftë në institucione shëndetësore apo në kushte shtëpie, ka rëndësi jetike, para së gjithash për gjendjen e tyre emocionale. Po ashtu, ai është thelbësor për të ruajtur vazhdimësinë në ndjekjen e programit mësimor dhe për përparimin e nxënësit në procesin arsimor.

Me qëllim të mundësimin të përfshirjes së nxënësve në procesin edukativ - arsimor në mjedisin e tyre shkollor, me mësimdhënësit dhe shokët e klasës, është miratuar Rregullorja për mënyrën e zgjedhjes së shkollës fillore, kriteret më të afërta dhe mënyrën e organizimit të mësimin në institucione shëndetësore, institucione dënimi-korrigjuese dhe institucione edukativo-korrigjuese, si dhe në kushte shtëpiake (Gazeta Zyrtare nr. 161/19; 229/20; 3/25 dhe 47/25, datë 30.6.2025)¹ me të cilën është rregulluar se:

1 <https://portal.mdt.gov.mk/post-body-files/pravilnici-mon-file-QjP2.pdf>

- 1 | Mësimi për nxënësit që, për shkak të arsyeve të mëdha shëndetësore ose sëmundjeve kronike, ndodhen në trajtim për më shumë se 3 (tri) javë dhe nuk mund të marrin pjesë në mësimin e rregullt në shkollë, realizohet nga shkolla ku është regjistruar nxënësi, në varësi të gjendjes së tij shëndetësore dhe mundësive, përmes mësimin në largësi me përdorimin e komunikimit elektronik, me prani fizike ose në formë të kombinuar;
- 2 | Shkolla ku është regjistruar nxënësi siguron stafin mësimor, programet dhe materialet, kryen vlerësimin dhe notimin e njohurive të nxënësit dhe mban evidencën pedagogjike për nxënësin;
- 3 | Mësimi në largësi/distancë realizohet përmes komunikimit sinkron, duke përfshirë nxënësit në orët e mësimin sipas orarit të orëve të klasës së tyre së bashku me shokët dhe shoqet e klasës, ose përmes përfshirjes së nxënësit në orë individuale mësimore në kohë të përshtatshme sipas mundësive të mësimdhënësve dhe nxënësit, dhe përmes komunikimit asinkron, duke realizuar punën e nxënësit mbi detyrat e caktuara nga mësimdhënësit, përmes dorëzimit të materialeve dhe sigurimit të komunikimit të kthyesëm, me qëllim monitorimin e arritjeve të nxënësit;
- 4 | Mësimi mund të realizohet edhe me prani fizike të mësimdhënësve në shtëpinë e nxënësit, në varësi të kapaciteteve të stafit të shkollës dhe gjendjes shëndetësore të nxënësit;

- 5 | Mësimi realizohet në gjuhën amtare me një qasje të diferencuar në planifikimin dhe realizimin e programit mësimor, ku mësimdhënësi përshtat programin sipas gjendjes shëndetësore të nxënësit;
- 6 | Shkolla mban evidencën pedagogjike për nxënësin në ditarin e klasës, ndërsa në ditarin elektronik shënohet lloji i mësimit të realizuar (mësim në largësi/distanca – komunikim sinkron, komunikim asinkron ose me prani fizike).

Për të siguruar një qasje të unifikuar në realizimin e procesit arsimor-edukativ për nxënësit, ky doracak ofron udhëzime praktike për shkollat fillore për realizimin e mësimit, si dhe një pasqyrë të pasojave të zakonshme të terapisë dhe sëmundjes mbi gjendjen njohëse dhe emocionale të nxënësit, duke përfshirë këshilla praktike për tejkalimin e tyre..

1. Realizimi i mësimit për nxënësit që ndodhen në trajtim të gjatë në institucione shëndetësore ose në kushte shtëpie

Në këtë pjesë të doracakut përmbahen udhëzime praktike për shkollat mbi realizimin e mësimit për nxënësit që ndodhen në trajtim për më shumë se tri (3) javë, qoftë në institucione shëndetësore, qoftë në kushte shtëpiake.

1.1. Procedura për përfshirjen e nxënësit në mësim gjatë kohës që është në trajtim

Kur prindi ose kujdestari njofton se nxënësi do të mungojë më shumë se tri javë për arsye shëndetësore, prindi/tutori është i detyruar të dorëzojë një kërkesë në shkollë për realizimin e mësimit gjatë kohës që nxënësi është në trajtim, ku përcaktohet arsyeja e mungesës dhe bashkëngjitet një opinion i mjekut kompetent (mjek familjeje ose specialist) që vërteton se nxënësi nuk mund të ndjekë mësimin, me kohëzgjatjen e pritshme të trajtimit. Ky hap është vendimtar për të inicuar procedurën.

Pas pranimi të kërkesës, shkolla (drejtori dhe shërbimi profesional) ka detyrimin brenda 3 ditëve nga pranimi i saj të shqyrtojë kërkesën. Nëse kërkesa shoqërohet me dokumentacionin mjekësor përkatës dhe arsyetimin mjekësor, shkolla jep miratimin për organizimin e mësimit për nxënësin gjatë kohës që ndodhet në trajtim dhe e informon prindin mbi hapat e mëtejshëm, pra mbi mënyrën dhe procedurën për realizimin e mësimit gjatë mungesës së nxënësit. Në këtë fazë, është shumë e rëndësishme që në fillim të vendoset bashkëpunim i ngushtë midis shkollës dhe prindit për

të përcaktuar mënyrën e komunikimit, për të sqaruar mundësitë e nxënësit dhe për të diskutuar planin e mësimi, duke vlerësuar nëse ai përputhet me kapacitetet shëndetësore të nxënësit.

Nëse mungon dokumentacioni mjekësor ose arsyetimi mjekësor, shkolla mund ta refuzojë kërkesën me arsyetim dhe e dorëzon këtë vendim te prindi/kujdestari.


Përfshirja e nxënësve në mësimin e rregullt gjatë kohës që ndodhen në trajtim është shumë e rëndësishme, dhe shkollat duhet t'i inkurajojnë prindërit/kujdestarët që të përfshijnë nxënësit në procesin arsimor, t'u shpjegojnë atyre se kjo mundësi ligjore ka rëndësi për nxënësin dhe t'i motivojnë në mënyrë të vazhdueshme për përfshirjen e nxënësve sa herë gjendja shëndetësore e lejon këtë.

1.2. Planifikimi i mësimi

1.2.1. Zgjedhja e mënyrës së realizimit të mësimi

Pasi kërkesa të aprovohet, shkolla harton një plan për mënyrën e realizimit të mësimi për nxënësin, duke marrë parasysh gjendjen e tij shëndetësore, moshën dhe mundësitë teknike. Ekzistojnë disa mënyra (modalitete) për zhvillimin e mësimi, të cilat mund të kombinohen, në varësi të situatës.





Modalitetet për realizimin e mësimit
në kushte shtëpiake/institucione
shëndetësore

1. Mësimi në largësi

- | komunikim sinkron
- | komunikim asincron

2. Mësim në shtëpinë e nxënësit ose
në institucionin shëndetësor

3. Model i kombinuar
(kombinimi i llojeve të
ndryshme të modaliteteve
të mësimit)

1.2.1.1. Mësimdhënia përmes të nxënës në distancë

Mësimi përmes arsimit në largësi organizohet duke përdorur platforma dhe mjete digjitale arsimore për mbështetjen e procesit edukativ, në përputhje me Konceptin për zhvillimin e sistemit të arsimit në largësi në shkollat fillore dhe të mesme, si dhe me Udhëzimin për metodologjinë e mësimdhënies në distancë në arsimin fillor dhe të mesëm.

Komunikimi sinkron:

Nëse nxënësi, në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore dhe mundësitë teknike, është në gjendje të ndjekë mësimin përmes komunikimit sinkron, shkolla e realizon mësimdhënien përmes Platformës Kombëtare për mësim në largësi/distancë, në kombinim me mjete për videokonferenca si Microsoft Teams. Në këtë rast, nxënësi zakonisht inkuadrohet/ndjek orët nga shtëpia ose nga institucioni shëndetësor në të njëjtën kohë me bashkëmoshatarët në klasë, pra e ndjek mësimin në mënyrë sinkrone, sipas orarit të klasës së tij, aq sa ia lejon gjendja shëndetësore. Në këtë mënyrë, nxënësi mund ta dëgjojë drejtpërdrejt mësimin nga mësimdhënësit e tij, të marrë pjesë në diskutime (duke aktivizuar kamerën ose mikrofoning) dhe të ndiejë se është pjesë e klasës. Shkolla duhet të sigurojë kushte teknike për zhvillimin e këtij procesi (p.sh. krijimin me kohë të profilin të përdoruesit për nxënësin në platformë, ndarjen e lidhjeve (linkun) për pjesëmarrje në orë, etj.).

Shkolla, në marrëveshje me prindin ose tutorin, mund të organizojë edhe orë mësimore individuale me komunikim sinkron, nëse vlerësohet se një mënyrë e tillë e mësimdhënies do të sjellë përfitime më të mëdha arsimore për nxënësin.

Komunikim asinkron:

Nëse nxënësi nuk mund të marrë pjesë në mësimdhënie përmes komunikimit sinkron për shkak të gjendjes shëndetësore (p.sh.,

është i dobët për të qëndruar gjatë para ekranit ose ka një orar terapish të paparashikueshëm), atëherë mësimi në distancë organizohet përmes komunikimit asinkron.

Mësimdhënësit përgatisin materiale mësimore, prezantime, detyra, detyra shtëpie ose sigurojnë video-mësime të regjistruara, të cilat nxënësi mund t'i punojë në mënyrë të pavarur në kohën kur ndjehet më mirë. Materialet mund të dorëzohen në formë elektronike (përmes platformës, e-mail-it, aplikacioneve të telefonit etj.) ose në formë fizike (të printuara) në shtëpi ose në institucionin shëndetësor.

Në këtë proces, është shumë e rëndësishme që mësimdhënësit të sigurojë informacion të kthyeshëm, duke kontrolluar rregullisht punën e nxënësit (p.sh., përmes shqyrtimit të detyrave të dorëzuara, bisedave telefonike ose konsultimeve online) dhe duke dhënë udhëzime për përmirësim. Kjo qasje siguron fleksibilitet, duke lejuar që nxënësi të mësojë sa dhe kur mund, në përputhje me ndryshimet në gjendjen shëndetësore, ndërkohë që mbetet në ritmin e materialit mësimor.

1.2.1.2 Mësimd-hënia në shtëpinë e nxënësit ose në institucionin shëndetësor

Nëse ekzistojnë kushtet e nevojshme, dmth. shkolla ka kapacitet të mjaftueshëm stafi dhe gjendja shëndetësore e nxënësit e lejon (nxënësi është në gjendje të qëndrueshme, nuk ka rrezik të lartë nga infeksionet, dhe shkolla ka stafin e nevojshëm në dispozicion), mësimi mund të organizohet edhe përmes vizitave të mësimdhënësit në shtëpinë e nxënësit ose në institucionin shëndetësor ku ai/ajo po trajtohet.

Për shembull: Shkolla cakton një mësimdhënë (ose një ekip Mësimdhënësisht) i cili/ e cila disa herë në javë do ta vizitojë nxënësin në shtëpi ose në institucionin shëndetësor për të zhvilluar orën mësimore me prani fizike. Ky model i mësimdhënies është veçanërisht i dobishëm për nxënësit më të vegjël, nga klasa

1 deri në klasën 3, ku kontakti fizik dhe prania e mësimitdhënësit/ mësimitdhënësve siguron një ambient më të sigurt për nxënësit për të përvetësuar programin mësimor.

Gjithashtu, ky model mund të përdoret edhe kur nxënësi nuk ka kushte teknike për të ndjekur mësimin në distancë me komunikim sinkron, deri në tejkalimin e situatës ose sigurimin e kushteve teknike të nevojshme për realizimin e mësimin në distancë me komunikim sinkron.

Përzgjedhja e këtij modeli kërkon vëmendje të veçantë në përputhje me protokollet shëndetësore: vizitat e mësimitdhënësit/ekipit të mësimitdhënësve duhet të jenë të koordinuara me protokollet shëndetësore, mësimitdhënësi duhet të jetë i shëndetshëm, të përdorë pajisje mbrojtëse nëse është e nevojshme (maskë, dezinfektues), dhe orët nuk duhet të lodhin nxënësin.

1.2.1.3. Modeli i kombinuar

Ky modalitet i mësimitdhënies nënkupton realizimin e mësimin përmes kombinimit të modeleve të ndryshme, të cilat përshtaten me gjendjen shëndetësore dhe mundësitë e nxënësit.

Për shembull: Nxënësi gjatë ditës mund të ndjehet mirë dhe të ndjekë pjesë të orëve mësimore përmes komunikimit sinkron, por për shkak të lodhjes mund të kërkojë ndërprerjen e mësimin sinkron, ndërsa pjesa tjetër e orëve sipas orarit të klasës të realizohet përmes komunikimit asinkron. Gjithashtu, sipas vlerësimit të mësimitdhënësit për një lëndë të caktuar, mësimi mund të zhvillohet përmes komunikimit asinkron duke siguruar materiale dhe detyra, ndërkohë që mund të organizohet një orë individuale sinkrone për të siguruar informacion të kthyesëm dhe udhëzime për nxënësin.

Karakteristika kryesore e këtij modeli është **fleksibiliteti**, domethënë mënyra e realizimit të mësimin përshtatet sipas periudhave të trajtimit, ndryshimeve në gjendjen e nxënësit, mundësive të tij, gjendjes

emocionale, si dhe vlerësimit të mësimdhënësit për zgjedhjen e metodës që do të ketë efekt më të madh në arritjet e nxënësit.

1.2.2. Sigurimi i mësimdhënësve dhe materialeve mësimore

Shkolla fillore ku është regjistruar nxënësi realizon mësimin, duke siguruar **stafin mësimor, programin dhe materialet mësimore**. Drejtori, në koordinim me shërbimin profesional, siguron stafin mësimor për realizimin e mësimin për nxënësin.

Zakonisht, në realizimin e mësimin përfshihen mësimdhënësit klasor dhe ata lëndor që japin mësim në klasën ku është regjistruar nxënësi, pasi ata e njohin nxënësin dhe arritjet e tij para gjendjes shëndetësore. Kjo qasje gjithashtu lehtëson reintegrimin e nxënësit në mësimin e rregullt pas përfundimit të trajtimit, pasi nxënësi dhe mësimdhënësi kanë qenë në komunikim të vazhdueshëm dhe mësimdhënësi e di për arritjet e nxënësit gjatë trajtimit. Nëse këta mësimdhënës nuk janë të disponueshëm, shkolla mund të caktojë mësimdhënës të tjerë.

Mësimdhënësit përgatisin të gjithë materialet e nevojshme mësimore: libra shkollorë, fletore, fletë pune, prezantime, incizime audio/video etj. Prindi ose tutori është përgjegjës të marrë librat shkollorë për nxënësin nga shkolla, ndërsa materialet mësimore mund të dërgohen në formë elektronike tek nxënësi ose në formë të printuar të merren nga prindi/ tutori në shkollë.

Nëse komunikimi sinkron/asinkron nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së kushteve teknike nga vetë nxënësi (mungesë kompjuteri/ tableti ose interneti), shkolla, nëse ka mundësi, duhet të sigurojë pajisje TIK (kompjuter, tablet ose internet), ndërsa nëse nuk ka mundësi, është e detyruar të kontaktojë themeluesin me qëllim që të gjendet një mënyrë për tejkalimin e kësaj situate dhe sigurimin e kushteve të nevojshme teknike për realizimin e mësimdhënies me mësim në largësi.

1.2.3. Orari i orëve mësimore

Pas përzgjedhjes së modelit për realizimin e mësimdhënies dhe sigurimit të mësimdhënësve, shkolla duhet të hartojë orarin e mësimëve për nxënësin që është në trajtim mjekësor, në konsultim me mësimdhënësit dhe prindin.

Ora mësimore zgjat 40 minuta, por mund të jetë edhe më e shkurtër, në varësi të gjendjes shëndetësore të nxënësit.

Rekomandohet që nxënësi, nëse është e mundur, të ndjekë mësimet sipas orarit të rregullt të klasës, në mënyrë që të ruajë rutinën dhe kontaktin me shokët e klasës. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se orari i mësimëve duhet të jetë fleksibël dhe i përshtatshëm me mundësitë shëndetësore të nxënësit. Ky orar mund të përshtatet sipas modeleve të ndryshme të mësimdhënies.

Përshembull: Mund të planifikohet që nxënësi të përfshihet në komunikim sinkron çdo ditë pune, në një orar të caktuar me marrëveshje (p.sh. në orën e parë për Gjuhën amtare dhe në orën e tretë për Matematikë), ndërsa lëndët e tjera t'i zhvillojë përmes komunikimit asinkron. Ose, mësimi mund të realizohet përmes komunikimit asinkron, ndërsa një herë në javë të organizohen orë individuale sinkrone me nxënësin.

Orari i orëve mësimore i dakorduar i dorëzohet prindit/tutorit, i cili është i detyruar të jetë në komunikim të vazhdueshëm me shkollën (me kujdestarin e klasës) dhe të informojë për çdo ndryshim në orar, përkatësisht për mundësinë ose pamundësinë e përfshirjes së nxënësit në mësim, varësisht nga gjendja e tij shëndetësore.

1.2.4. Plani mësimor dhe programi mësimor

Mësimi për nxënësit realizohet në gjuhën e tyre amtare sipas planit dhe programit mësimor për klasën përkatëse, me përdorimin e një qasjeje të diferencuar në planifikimin dhe realizimin e mësimi, në përputhje me gjendjen shëndetësore të nxënësit.

Sigurisht, çdo nxënës që është në trajtim mjekësor ka nevoja dhe mundësi të ndryshme, që do të thotë se mësimdhënësit duhet të përshtatin programin për të mundësuar pjesëmarrjen e nxënësit dhe arritjen e rezultateve kryesore të të nxënësit. Për shembull, nxënësi mund të mësojë një njësi tematike për një kohë më të gjatë ose të përqendrohet në njësi tematike të thjeshtuara gjatë periudhave kur gjendja shëndetësore nuk lejon pjesëmarrje të plotë, ndërsa aktivitetet më të ndërlikuara mund të lihen për periudhën kur nxënësi do të rikthehet në mësim të rregullt.

Mësimdhënësit duhet të përdorin një qasje të diferencuar, që do të thotë se mund të përshtatin metodologjinë sipas mundësive aktuale të nxënësit. Nëse nxënësi ka vështirësi me koncentrimin (gjë që është e zakonshme tek nxënësit në trajtim mjekësor), mësimdhënësit mund të ofrojnë detyra më të shkurtra dhe më të thjeshta, mjete vizuale më shumë ose aktivitete interaktive që mbajnë vëmendjen e tij. Nëse nxënësi është fizikisht i dobët dhe nuk mund të shkruajë shumë, i lejohet të japë përgjigjet gojariht ose përmes kompjuterit (p.sh., duke klikuar përgjigjen e saktë, duke regjistruar përgjigje audio etj.). Mësimdhënësi mund të hartojë një plan edukativ individual me qëllime konkrete për atë periudhë, i cili do të ndryshojë nga plani i bashkëmoshatarëve vetëm aq sa është e nevojshme. Për shembull, për vlerësim nxënësi mund të realizojë një projekt ose prezantim më të vogël në vend të një testi standard të shkruar, nëse kjo i përshtatet më mirë. **Qasja e diferencuar nënkupton edhe fleksibilitet në kriteret e vlerësimit**, dmth. mësimdhënësi vlerëson përparimin e nxënësit në raport me arritjet e tij/paraprakisht, dhe jo sipas standardeve absolute të klasës në një moment të caktuar. Qëllimi është që nxënësi të përparojë vazhdimisht, edhe me një ritëm më të ngadaltë, pa ndjerë presionin se "mbetet prapa".

1.3. Realizimi i mësimit dhe ndjekja e vazhdueshme

Pasi të fillojë mësimi sipas modelit të planifikuar, orarit dhe programit mësimor, mësimdhënësit e realizojnë mësimin sipas orarit të përcaktuar, duke u përshtatur me gjendjen ditore të nxënësit. Për realizimin e suksesshëm të mësimit është e nevojshme komunikim i rregullt me nxënësin dhe prindin, dmth. para çdo ore të konfirmohet nëse nxënësi mund të marrë pjesë, dhe nëse është e nevojshme të ndryshohet ora ose të shkurtëzohet koha e mësimit. Ky komunikim është i rëndësishëm edhe për arritjet e nxënësve.

Mësimdhënësit ndjekin angazhimin e nxënësit. Nëse vërejnë se nxënësi ka vështirësi në përvetësimin e një përmbajtjeje të caktuar, bëhen përshtatje. Për shembull, materiali ripërsëritet, detyrat thjeshtohen ose disa tema shtyhen për më vonë. Është veçanërisht e rëndësishme që mësimdhënësi të tregojë mirëkuptim dhe durim. Nëse nxënësi në një ditë të caktuar nuk mund të marrë pjesë (për shkak të dhimbjeve, lodhjes etj.), mësimi shtyhet ose realizohet me intensitet minimal atë ditë. Përmes kësaj qasjeje fleksibile, nxënësi do të përparojë sipas mundësive të tij, ndërkohë që do të ndjejë se shkolla kujdeset për suksesin e tij.

Është e rëndësishme të theksohet se problemet shëndetësore mund të ndikojnë në gjendjen psikike të nxënësit. Nxënësi mund të ndihet i izoluar, i shqetësuar (ankth) ose i demotivuar. (Shih pjesën 2 – Ndryshimet e zakonshme tek nxënësit për shkak të gjendjes shëndetësore). Prandaj, është shumë e rëndësishme që mësimdhënësit të veprojnë me empati të madhe, mirëkuptim dhe inkurajim. Duhet të evitohen përcaktimi i afateve të rrepta ose pritshmëri të tepruara. Në vend të kësaj, duhet të festohet çdo përparim, sa i vogël qofshin. Ndonjëherë është më e dobishme për nxënësin të bëhen pyetje për mënyrën se si ndihet, të tregohet interes për shëndetin e tij, dhe të përfshihet në biseda për tema të përgjithshme. Kjo do të ndihmojë në ruajtjen e vetëbesimit dhe motivimit të tij.

Mësimdhënësi mund të përfshijë edhe bashkëmoshatarët në realizimin e mësimi. Për shembull, në orën e arsimit figurativ ata mund të realizojnë një vizatim ose ndonjë krijim artistik dhe ta dërgojnë te nxënësi. Në orën e gjuhës amtare mund të shkruajnë një krijim letrar, ose në orën e informatikës të përfshihen në një bisedë/video të shkurtër me nxënësin nga klasa, nëse ai/ajo ka dëshirë për këtë. Qëllimi kryesor është që, përveç arritjes së rezultateve mësimore, nxënësi të ndjejë se shkolla është aty për të, ndërsa kontakti me mësimdhënësin dhe bashkëmoshatarët ka një vlerë të paçmueshme për gjendjen emocionale të fëmijës.

1.4. Mbajtja e evidencës pedagogjike dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësit

Shkolla mban evidencë pedagogjike për nxënësin. Çdo orë e realizuar përmes mësimi në largësi apo distancë me komunikim sinkron ose asinkron dhe/ose me praninë fizike të mësimdhënësit në kushte shtëpie ose në institucion shëndetësor shënohet në ditarin elektronik, përkatësisht te vërejtje për orën dhe shënohet mënyra se si është realizuar. Për shembull: "ora u realizua me komunikim sinkron", "ora u realizua me komunikim asinkron" ose "ora u realizua me praninë fizike në shtëpi/institucion shëndetësor".

Mësimdhënësit duhet të kontrollojnë rregullisht njohuritë e nxënësit dhe të vlerësojnë arritjet e tij përmes formave të ndryshme, si: verifikime gojore, kuize online, fletë-mësimore, detyra/hartime të shkruara, projekte, prezantime etj.

Gjatë zbatimit të qasjes së diferencuar në mësim, ndiqet edhe parimi i fleksibilitetit në kriteret e vlerësimit të arritjeve të nxënësit. Mësimdhënësi kujdeset për motivimin e nxënësit, rregullshmërinë

dhe përfshirjen e tij, përparimin e nxënësit në krahasim me arritjet e mëparshme, aktivitetin dhe angazhimin e tij. Qëllimi është që nxënësi të përparojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të zotërojë njohuri sipas programit të përshtatur me gjendjen shëndetësore të tij.

Arritjet e nxënësit për tremujorin e parë, gjysmëvjetorin, tremujorin e dytë dhe fundin e vitit shkollor shënohen në fletën evidentuese. Edhe pse nxënësi ka punuar sipas një programi të përshtatur me qasje të diferencuar për shkak të gjendjes shëndetësore, kjo nuk shënohet në fletën evidentuese për shkak të mbrojtjes së të dhënave shëndetësore të nxënësit.

1.5. Përcjellja e vazhdueshme e komunikimit

Në procesin e angazhimit arsimor të nxënësit që është në trajtim më afatgjatë, ndjekja e vazhdueshme dhe komunikimi efektiv ndërmjet të gjitha palëve të përfshira kanë rëndësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të mësimi. Udhëheqësi/kujdestari i klasës, së bashku me mësimdhënësit lëndor, pedagogun dhe psikologun, duhet periodikisht të mbajnë takime me qëllim:

- ▣ Shkëmbim informatash për rrjedhën e mësimi;
- ▣ Analizën e përparimit dhe shkallës së përfshirjes së nxënësit në orët dhe aktivitetet e planifikuara;
- ▣ Përcaktimin e nevojës për mbështetje shtesë ose përshtatje të qasjes mësimore.

Është veçanërisht e rëndësishme që gjatë këtyre takimeve të shqyrtohen edhe reagimet dhe informacionet e kthyer nga prindi/tutori dhe vetë nxënësi, me qëllim që të vlerësohet nëse dinamika, përmbajtja dhe mënyra e realizimit të mësimit përputhen me gjendjen shëndetësore dhe mundësitë e nxënësit. Për shembull, nëse prindi/kujdestari vëren se komunikimi sinkron shkakton lodhje ose stres të tepërt te nxënësi, plani për realizimin e mësimit duhet të rishikohet – përkatësisht të kalohet në një formë asinkrone së të mësuarit ose të ulët intensiteti i orëve.

Kjo qasje mundëson mbështetje fleksibël, humane dhe të individualizuar, ku nxënësi mbetet aktivisht i përfshirë në procesin arsimor në përputhje me mundësitë dhe nevojat e tij aktuale. Nxënësit që janë në trajtim kanë një gjendje shëndetësore të ndryshueshme, prandaj mësimeve duhet ta ndjekin rregullisht dhe ta përshtatin mësimin sipas nevojave të nxënësit.



**Gjendja shëndetësore
ndikon në gjendjen fizike,
kognitive dhe emocionale
të nxënësve**



Terapitë e ndryshme për trajtimin, si dhe vetë sëmundja, mund të shkaktojnë një sërë efekteve të padëshiruara që ndikojnë në gjendjen fizike, kognitive dhe emocionale të nxënësve që janë në trajtim. Më poshtë përmenden disa nga sfidat më të shpeshta me të cilat përballen nxënësit në trajtim, të cilat janë të rëndësishme për mësimdhënësit që realizojnë mësimin, për të mundësuar përshtatjen e programit sipas gjendjes shëndetësore të nxënësit dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e tij dhe arritjen e rezultateve të të nxënës.

✓ **Imuniteti i ulët (imunosupresioni):**

Disa terapi, veçanërisht kimioterapia, zvogëlojnë funksionin e sistemit imunitar, që do të thotë se nxënësit kanë një rrezik më të madh nga infeksionet. Për këtë arsye, nxënësi nuk duhet të ketë kontakt që mund të paraqesë rrezik për të, dhe prandaj përdorimi i modelit të mësimin me kontakt fizik me mësimdhënësin gjatë kësaj periudhe nuk rekomandohet. Nëse përdoret, duhet të respektohen të gjitha protokollat shëndetësore për mbrojtjen e nxënësit. Pas përfundimit të trajtimit dhe gjatë riintegrit të nxënësit në mësimin e rregullt, mësimdhënësi kujdestar/udhëheqësi i klasës është i detyruar të informojë prindin/tutorin për çdo sëmundje infektive që mund të shfaqet në shkollë, për të mundësuar mbrojtjen e duhur dhe në kohë të shëndetit të nxënësit.

✓ **Ndjenja të të përzierit ose të vjella:**

Nxënësit që janë në trajtim, veçanërisht pacientët hematologjikë-onkologjikë, mund të përjetojnë disa efekte të padëshiruara të terapisë, si ndjenja e të përzierit dhe të vjellat. Ky efekt mund të shfaqet brenda 24 orëve pas marrjes së terapisë, por edhe për një periudhë më të gjatë. Në ditët e tilla, nxënësi nuk mund të përqendrohet në mësim, prandaj është e rëndësishme të ndërpritet përkohësisht realizimi i orëve deri sa ky efekt të kalojë. Komunikimi me prindin/tutorin është i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe. Me informacionin që nxënësi nuk ndihet mirë, përshtatet orari i mësimit dhe mësimi vazhdon vetëm kur nxënësi ndjehet mirë dhe është i gatshëm të përfshihet përsëri në procesin mësimor.

✓ **Lodhje dhe pafuqi:**

Lodhja kronike është një dukuri e zakonshme tek nxënësit që janë në trajtim. Këta nxënës lodhen më shpejt, gjë që shpesh çon në përqendrim të reduktuar dhe vështirësi në ndjekjen e mësimit. Është e rëndësishme të kuptohet se lodhja kronike nuk është thjesht një lodhje e zakonshme – ajo mund të zgjasë javë ose muaj dhe të ndikojë ndjeshëm në energjinë, disponimin dhe motivimin e nxënësit. Për këtë arsye, fleksibiliteti përbën një parim kryesor në realizimin e mësimit për nxënësit që janë në trajtim. Mësimdhënësit, së bashku me prindërit/tutorët, duhet të tregojnë kuptueshmëri dhe aftësi për t'u përshtatur në lidhje me pritshmëritë për përparimin e nxënësit dhe realizimin e programit mësimor. Nëse nxënësi ndjek mësim nga distanca me komunikim sinkron, ai mund të përfshihet në orët e rregullta, por me një ritëm të përshtatur që përputhet me mundësitë e tij shëndetësore. Në këto raste, mësimdhënësit mund të:

- ▣ Të ulin vëllimin e detyrave dhe obligimeve të shtëpisë,
- ▣ Ta shkurtojnë kohëzgjatjen e orës mësimore,
- ▣ Ose të parashikojnë seanca më të shpeshta, por më të shkurtra, për të ruajtur përqendrimin dhe energjinë e nxënësit:

Kur mësimi realizohet përmes orëve individuale me komunikim sinkron, rekomandohet që kohëzgjatja të jetë më e shkurtër se 40 minutat standarde, duke u përshtatur sipas gjendjes aktuale të nxënësit. Kjo qasje siguron mësim të përshtatur dhe mbështetës, me fokus në vazhdimësinë e të nxënës pa shtypje ose mbingarkesë për nxënësin.

✓ **Përgjumsia që ndikon në aftësitë kognitive:**

Disa terapi mund të shkaktojnë periudha të përgjumjes tek nxënësi që zgjasin një deri dy javë. Përgjumja ndikon në aftësitë kognitive, dhe gjatë kësaj periudhe nxënësi thjesht nuk do të jetë në gjendje të ndjekë mësimin. Për këtë arsye, mësimi ndërpritet dhe vazhdon sipas marrëveshjes me prindin/tutorin sapo të kalojë përgjumja.

✓ **Dobësi të muskujve dhe dhimbje në nyje:**

Disa medikamente mund të shkaktojnë dobësi muskulore, dhimbje, probleme me ekuilibrin dhe koordinimin. Gjatë trajtimit, kjo gjendje, veçanërisht dhimbjet në duar, mund të ndikojë në aftësinë e nxënësit për të shkruar detyra ose për të përgatitur prezantime/projekte. Është e rëndësishme që kjo gjendje të komunikohet nga prindi/tutori, pas së cilës mësimdhënësi mund të bëjë përshtatje të mësimin përmes verifikimeve gojore. Për më tepër, pas rikthimit të nxënësit në shkollë, mund të nevojitet ndihmë fizike, për shembull, ndihma nga një shok klase për të mbajtur çantën shkollore për shkak të dhimbjeve ose dridhjes së duarve.

✓ **Ndryshimet në pamjen fizike:**

Trajtimi, veçanërisht kimioterapia, mund të shkaktojë përkohësisht ndryshime në pamjen fizike, si humbja e flokëve (përfshirë vetullat dhe qerpikët), humbje ose shtim të peshës, ndryshime të lëkurës (thatësi, njolla) ose shenja nga operacionet. Këto ndryshime mund të jenë shumë të ndjeshme për nxënësin, sidomos për adoleshentët, duke shkaktuar pasiguri dhe frikë nga reagimet e të tjerëve. Para se nxënësi të përfshihet në mësim përmes komunikimit sinkron, mësimdhënësi duhet të përgatisë shokët e klasës për ndryshimet fizike të ndodhura dhe të sigurohet që kjo situatë të mos ndikojë negativisht as te nxënësi, as te shokët e tij, duke parandaluar shaka ose përbuzje për pamjen e ndryshuar. Nëse mësimdhënësi vëren që nxënësi shmang pjesëmarrjen me kamerën aktive për shkak të shqetësimit për pamjen e tij, duhet të bisedojë me të, duke ofruar mbështetjen e tij dhe të klasës. Ky ndryshim mund të ndikojë te nxënësi edhe pas rikthimit në mësimin e rregullt në shkollë. Prandaj, njohja e hershme e këtij shqetësimi është shumë e rëndësishme, sepse nëse nxënësi nuk merr ndihmën e duhur, është e mundur që ai të tërhiqet, të fillojë të shmangë mësimin dhe të izolojë veten nga shokët e klasës.

✓ **Efektet emocionale:**

Trajtimi është stresues për nxënësin. Disa nxënës mund të përjetojnë efekte emocionale të forta, të jenë më të frikësuar, të shqetësuar, të irritueshëm dhe të kenë ndryshime në humor. Të tjerët mund të kenë frikë të ndahen nga prindërit/ tutorët gjatë reintegrimit në mësimin e rregullt ose të ndihen të vetmuar dhe të izoluar nga jeta shkollore. Në këtë proces, roli i mësimdhënësit është thelbësor. Empatia, durimi dhe mbështetja janë shumë të rëndësishme për përballimin e gjendjes emocionale dhe do të kenë një ndikim të madh për nxënësin.

Shumica e nxënësve presin me padurim të kthehen sa më shpejt në rutinën normale shkollore, të takojnë shokët e klasës, të ulen në bankat shkollore dhe të jenë „si të tjerët“. Megjithatë, njëkohësisht ata mund të kenë edhe disa frikëra dhe shqetësime lidhur me vazhdimin e arsimit gjatë trajtimit ose pas rikthimit në mësimin e rregullt. Më poshtë jepen disa shembuj të shqetësimeve dhe teknikat për t'i tejkaluar ato:

✓ **"Dukem më ndryshe, çka do të thonë të tjerët?"**

Ndryshimet në pamje (mungesë e flokëve, dobësim/mbipesha, shenja) shkaktojnë pasiguri dhe turp për shumë nxënës. Shqetësimi kryesor i tyre është se ndryshimi i pamjes fizike mund të tërheqë vëmendje nga shokët e klasës dhe që mund të përballen me komente negative, të shihen si të "tjetër" ose të jenë objekt talljeje.

Kishilli i mësimdhënësve:

Përgatitini shokët e klasës. Mbani një orë me bisedë të hapur dhe shpjegojuni nxënësve (në mënyrë të kuptueshme dhe me empati) se çfarë po kalon shoku i tyre dhe se ndryshimet në pamje janë të përkohshme ose shenjë që ai po shërohet. Inkurajojini ta presin shokun e tyre me mirëseardhje, pa pyetje të pakëndshme, sikur të mos kishte munguar fare. Nëse nxënësi mban shami, kapelë ose paruke, theksoni se kjo e ndihmon të ndihet më mirë dhe se çdo shaka apo tallje mund ta lëndojë dhe ta bëjë të ndihet i trishtuar. Vëmendja juaj është gjithashtu shumë e rëndësishme: nëse vini re komente fyese ose tallje, reagoni menjëherë dhe bëni të qartë se një sjellje e tillë nuk do të tolerohet. Në këtë mënyrë do të parandaloni që nxënësi të ndihet i përjashtuar për shkak të turpit ose të zhvilloj ankth social afatgjat.

✓ **"Do të kem ngecje në mësim"**

Do të mbetem prapa në mësim..."Shumë nxënës shqetësohen se për shkak të trajtimit dhe orëve të humbura nuk do të jenë në gjendje të përfshihen përsëri në mësim dhe se do të mbeten shumë prapa të tjerëve."

Kishilli i mësimdhënësve:

Inkurajojeni nxënësin dhe shpjegojini se puna shkollore do të vazhdojë paralelisht me trajtimin sapo gjendja shëndetësore ta lejojë këtë. Theksoni se nuk ka nevojë t'i kryejë menjëherë të gjitha detyrat nga programi, por do të përqendroheni në gjërat më të rëndësishme dhe se çdo përparim do të festohet. Lejojeni nxënësin të zgjidhë detyra dhe të mësojë sipas mundësive që ia lejon gjendja shëndetësore. Inkurajojeni vazhdimisht duke i treguar se nuk është e nevojshme të kompensojë gjithçka menjëherë dhe lavdërojeni për çdo hap të vogël. Në këtë mënyrë, nxënësi do ta ruajë motivimin dhe me kalimin e kohës do të zvogëlohet shqetësimi i tij se po mbetet pas me mësimet. Ky proces gjithashtu do të ketë një ndikim të fortë në riintegrimin e tij më të lehtë në mësimin e rregullt pas përfundimit të trajtimit.

✓ **Kujdesi për humbjen e shoqërisë dhe izolimi:**

Mungesa e gjatë nga shkolla mund të shkaktojë tek nxënësi shqetësimin se miqtë e tij janë afruar më shumë me njëri-tjetrin dhe e kanë harruar, ndaj do të mbetet "mënjanë" kur të kthehet në shkollë. Po ashtu, nxënësi mund të jetë më i tërhequr dhe i ndryshuar pas gjithçkaje që ka përjetuar gjatë trajtimit, prandaj shokët e tij të klasës mund të mos dinë si t'i afrohen.

Kishilli i mësimdhënësve:

Mbani lidhje ndërmjet nxënësit dhe shokëve të klasës gjatë kohës sa nxënësi mungon. Përfshijeni në mësimin në distancë me komunikim sinkron sa herë që ka mundësi për këtë. Në këtë mënyrë, nxënësi e ndien atmosferën e klasës, ndërsa shokët e tij e dinë se ai është i pranishëm. Kur nuk ka mundësi për komunikim sinkron, përdorni gjeeste të thjeshta që kanë shumë kuptim: në orën e artit figurativ, shokët e klasës le t'i vizatojnë një vizatim, ose në orën e gjuhës amtare le t'i shkruajnë mesazhe të shkurtra si "ji i fortë, po të presim", ose organizoni një thirrje të shkurtër video nga klasa gjatë orës, ku të gjithë do ta përshëndesin shokun e tyre (me pëlqimin paraprak të prindërve/kujdestarëve).

Këto aktivitete do t'i tregojnë nxënësit se nuk është harruar dhe se miqësitë vazhdojnë pavarësisht ndarjes fizike. Pas kthimit të tij, vazhdoni të nxisni frymën e grupit: përfshijeni nxënësin në projekte grupore, besojini një rol në ndonjë aktivitet shkollor dhe festoni së bashku arritjet e tij.

Kërkimet tregojnë se pikërisht shokët/shoqet janë faktor kryesor në lehtësimin e shërimit të nxënësve dhe në riintegrimin e tyre më të lehtë në shkollë. Shokët/shoqet ofrojnë mbështetje emocionale dhe ndjesi normaliteti. Prandaj, është e rëndësishme që shkolla, përmes aktiviteteve të ndryshme, të kultivojë një mjedis ku shoqëria është pjesë e procesit të shërimit.



Shembull për realizimin e mësimit



Në këtë pjesë jepet një shembull hipotetik që ilustron se si do të zbatoheshin udhëzimet e lartpërmendura në situata konkrete. Këto skenarë tregojnë mënyrën e realizimit të mësimit për nxënës që, për shkak të problemeve shëndetësore ose sëmundjeve kronike, janë në trajtim mjekësor për më shumë se tre javë.

Skenari hipotetik:

Nxënësi me një sëmundje malinje hematologjike të diagnostikuar (leukemi) është në trajtim në një institucion shëndetësor dhe në kushte shtëpie.

Një nxënësi të klasës së pestë i është diagnostikuar leukemi dhe është e nevojshme të trajtohet në një institucion shëndetësor për një periudhë prej 2 muajsh, si dhe të vazhdojë trajtimin në kushte shtëpie. Për shkak të gjendjes shëndetësore, nxënësi do të mungojë nga mësimi i rregullt në shkollë për të paktën 8 javë.

Planifikimi i mësimi:

Prindi/Tutori e njofton shkollën për gjendjen shëndetësore të nxënësit. Gjatë këtij procesi, prindi me arsye është i shqetësuar për shkak të gjendjes shëndetësore të fëmijës dhe përparësi e tij është trajtimi mjekësor i nxënësit, e jo vazhdimi i menjëhershëm i procesit arsimor. Shkolla e kupton plotësisht këtë situatë dhe, përveç fjalëve të mbështetjes, i jep edhe një rekomandim prindit/kujdestarit që të paraqesë një kërkesë në shkollë për organizimin e mësimi, duke theksuar se realizimi do të jetë i përshtatshëm dhe do të zhvillohet sipas mundësive shëndetësore të nxënësit.

Pas dorëzimit të kërkesës nga prindi, shkolla e miraton kërkesën dhe formon një ekip (drejtorin, pedagogun dhe mësimdhënësin e klasor), i cili përgatit një plan për realizimin e mësimi në institucion shëndetësor ose në kushte shtëpie.

Për shkak të natyrës së sëmundjes, zgjidhet modeli i mësimi në largësi me komunikim sinkron dhe asinkron. Në bashkëpunim me prindin/tutorin përcaktohet nëse ekzistojnë mundësitë teknike për zbatimin e këtij modeli dhe përcaktohet mënyra e dërgimit të materialeve mësimore për nxënësin. Drejtori, shërbimi profesional, kujdestari i klasës dhe mësimdhënësit e nxënësit përgatisin orarin e mësimëve, përcaktojnë mënyrën e zbatimit të programit mësimor dhe e komunikojnë këtë me prindin/tutorin.

Realizimi i mësimdhënies:

Para fillimit të realizimit të mësimit, është me rëndësi t'i shpjegohet nxënësit se orari i orëve mësimore është fleksibël dhe se plani/programi mësimor do të përshtatet sipas mundësive të tij. Kështu që, nëse nxënësi në një ditë të caktuar nuk mund të punojë fare, orët do të shtyhen për një ditë tjetër. Është me rëndësi që nxënësi ta dijë paraprakisht se nuk ka presion se "duhet" të mësojë çdo ditë me çdo kusht dhe se për shkollën, shëndeti i tij është përparësi.

Në ditët kur nxënësi ndihet më mirë (p.sh. gjatë pushimeve ndërmjet seancave të kimioterapisë), organizohet mësim në largësi me komunikim sinkron përmes **Microsoft Teams**. Nxënësi i bashkohet disa orëve gjatë ditës bashkë me shokët e klasës, aq kohë sa ia lejon gjendja e tij shëndetësore. Mësimdhënësit dhe shokët e klasës e përshëndesin dhe i urojnë shëndet të mirë, pas çka e përfshijnë në diskutimin e orës aq sa ka fuqi. Ky kontakt me klasën është shumë i rëndësishëm për gjendjen e tij emocionale dhe motivimin.

Në ditët kur nxënësi nuk mund të përfshihet në mësimin në distancë me komunikim sinkron për shkak të gjendjes shëndetësore (p.sh. menjëherë pas terapisë, kur ka efekte anësore dhe ndihet i lodhur), mësimdhënësit i dërgojnë materiale, prezantime të shkurtra ose fletë pune përmes komunikimit asinkron. Për shembull, për lëndën e matematikës i përgatisin një video të shkurtër me mënyrën e zgjidhjes së një detyre që e kanë mësuar, të cilën mund ta shikojë kur të ndihet më mirë, si dhe një fletë pune me ushtrime; ose për gjuhën angleze i dërgojnë një inçizim audio me shqiptimin e fjalëve të reja dhe ushtrime në fletoren e punës.

Nëse nxënësi nuk ndihet mirë dhe nuk mund të punojë në detyrat e dhëna nga mësimdhënësi, mësimdhënësi e siguron se kjo është në rregull dhe se do të vazhdojnë kur ai të jetë në gjendje. Përveç aspektit formal të realizimit të mësimit, komunikimi joformal midis nxënësit dhe mësimdhënësit ka gjithashtu rëndësi të madhe, në mënyrë që nxënësi të mund të komunikojë lirshëm për vështirësitë me të cilat përballet gjatë përvetësimit të materialit. Në këtë mënyrë, mësimdhënësi gjithmonë do të mund të zbatojë një qasje të individualizuar, pra ta përshtasë programin sipas mundësive shëndetësore të nxënësit.

Shkolla mban evidencë pedagogjike për nxënësin dhe në ditarin elektronik shënon në rubrikën e vërejtjeve mënyrën se si është realizuar ora, ose: "ora është realizuar me komunikim sinkron", "ora është realizuar me komunikim asinkron" ose "ora është realizuar me prani fizike në shtëpi ose në institucion shëndetësor". Mësimdhënësit në mënyrë të vazhdueshme e vlerësojnë njohurinë e nxënësit dhe i ndjekin arritjet e tij.

Pas 8 javësh, nxënësi ndihet më mirë dhe kthehet në mësimin e rregullt. Falë mësimit të organizuar gjatë periudhës së trajtimit, nxënësi ka fituar njohuri në lëndët mësimore dhe ka vlerësime për atë tremujor, përkatësisht për gjysmëvjetorin, dhe e vazhdon arsimin së bashku me shokët e klasës pa pasur ndonjë boshllëk të rëndësishëm arsimor në krahasim me ta. Për më tepër, ai kthehet me një përvojë pozitive se mësimdhënësit kanë qenë gjithmonë pranë tij, gjë që e rrit entuziazmin e tij për t'u rikthyer në mësimin e rregullt në klasë.

Përpilues



Republika e Maqedonisë së Veriut

**Ministria e Arsimit
dhe Shkencës**



Министерство за образование и наука • Министерство за образование и наука
Ministria e Arsimit dhe Shkencës • Министерство за образование и наука
Ministry of Education and Science • Bureau for Development of Education

